



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 195, Datë, 26.11.2020

“MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “ENERGY SUPPLY - AL” SH.P.K., NR 309, SERIA T11/T15, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE NR. 6, DATË 02.02.2011 DHE RINOVUAR ME VENDIMIN NR. 122, DATË 14.10.2015”.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma d) të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma e); nenit 5, pika 1, gërma e); nenit 8, 9, 10, pikat 1 dhe 3 dhe nenit 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 19, pika 1, gërma “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE, në mbledhjen e datës 26.11.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 122/5 prot, datë 18.11.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, mbi kërkesën e shoqërisë “Energy Supply - AL” sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “Energy Supply - AL” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr.1185 prot, datë 10.11.2020, ka aplikuar për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, nr. 309, Seria T11/T15, miratuar me vendimin e Bordit nr. 6, datë 02.02.2011 dhe rinovuar me vendimin nr. 122, datë 14.10.2015.
- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Në datën 20.01.2010, është regjistruar pranë QKB, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k), konform ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” (QKB).
- Shoqëria “Energy Supply - AL” sh.p.k., është mbajtëse e licencës me nr. 309, Seria T11/T15, të tregtimit të energjisë elektrike, që prej datës 02.02.2011, dhënë me vendimin e Bordit të

Komisionerëve të ERE-s nr. 6, rinovuar së fundmi me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 122, datë 14.10.2015, për pesë vjet të tjera, deri në datën 03.02.2021.

- Në bazë të nenit 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, kërkesa për rinovimin e licencës nga aplikanti paraqitet: Jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.
- Aplikimi i shoqërisë “Energy Supply - AL” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, si më poshtë:
  - **Formati dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”) është paraqitur dhe plotësuar pjesërisht.**
  - **Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është paraqitur dhe plotësuar pjesërisht.**
  - **Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është paraqitur dhe plotësuar pjesërisht.**
  - **Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar pjesërisht.**
- **Neni 16. Pika 1 gërma “d”** (Vërtetim për kryerjen e pagesës së regjistrimit për aplikim dhe kërkesë për njohje në llogari të E.R.E.-s, sipas Aneksit A të kësaj rregullore.) **Plotësuar**

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

#### **Dokumentat juridike, administrative dhe pronësore**

##### **Neni 9, pika 2:**

- **gërma “d”** (Vërtetim që shoqëria dhe drejtuesit kryesorë të saj në rastin e personave juridikë, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata). **Plotësuar pjesërisht.**

Konstatohet mungesa e vërtetimeve të gjykatës dhe prokurorisë për përfaqësuesin me prokurë të shoqërisë. Shoqërisë do ti kërkohet depozitimi i tyre në zbatim të nenit 7, pika 2 të rregullores. Po ashtu vihet re edhe mungesa e vërtetimit të organeve të drejtësisë për administratoren (nga vendi i saj i origjinës), për të cilat do ti kërkohet shoqërisë depozitimi në ERE.

#### **Dokumentat financiare dhe fiskale, sipas nenit 9, pika 3**

- **gërma “c”** (Dokumenta që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.) **Pa plotësuar.** Duhet të depozitohet në ERE dokumentacionin mbështetës.

**Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, është plotësuar nga aplikanti si më poshtë:**

**Neni 9, pika 4.8:**

- **gërmat “a”/“d”** (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për tu tregtuar në GWh / sipas viteve); **Pa plotësuar**. Shoqëria duhet të depozitojë në vijim sasi të e kërkuara të energjisë të parashikuara për tu tregtuar.
- **gërma “b”** (Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj.); **Plotësuar pjesërisht**. Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin. Vetëm deklarata nuk përmbush këtë kërkesë të rregullores.
- **gërma “c”** (Lista e kontratave të mëparshme, nëse ka pasur). **Pa plotësuar**. Shoqëria nuk ka paraqitur kontratat e tregimit të energjisë elektrike që mund të ketë patur më parë, por duhet të depozitojë informacion lidhur me to.

Për gjithë sa më sipër, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 10, pika 9 dhe nenit 11, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë këto në ERE, brënda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 309, Seria T11/T15, të shoqërisë “Energy Supply - AL” sh.p.k., në veprimtarinë e tregimit energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit nr. 6, datë 02.02.2011 dhe rinovuar me vendimin e Bordit nr. 122, datë 14.10.2015, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 04.02.2021.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**